$$\left(2\frac{1}{3} - \frac{1}{4}\right) + \left(\frac{3}{2} + \frac{1}{12}\right) =$$

33. Distancën prej 120 km një autobus e bën për 3 orë.

a) Sa km bën autobusi në një orë?

1 pikë

b) Sa km bën autobusi për 5 orë?

1 pikë

34. Një parcelë ka formë drejtkëndore me përmasa 32 m dhe 12 m. Ndërtoni parcelën dhe gjeni perimetrin e saj.  
**2 pikë**


35. Paraqitni si thyesë numrin 6.1 **1 pikë**

\_\_\_\_\_

36. Nëse një shufër ka dy skaje, sa skaje kanë dy shufra e gjysmë? **1 pikë**

\_\_\_\_\_

37. Sa trekëndësha ka në figurën e mëposhtme? **1 pikë**



\_\_\_\_\_

38. Jepen shifrat 4, 8 dhe 0.

- a) Shkruani numrin më të vogël treshifror pa i përsëritur shifrat. **1 pikë**

\_\_\_\_\_

- b) Shkruani numrin më të madh treshifror pa i përsëritur shifrat. **1 pikë**

\_\_\_\_\_

**Dituri Natyre**

39. Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të vet shkakton:


- A) formimin e ditë – natës;
- B) formimin e stinëve;
- C) formimin e erërave;
- D) formimin e dallgëve.



1 pikë

40. Emërtoni llojin e eklipsit që formohet në figurën e mëposhtme.


\_\_\_\_\_



1 pikë

41. Në figurë jepen qarqet elektrik 1 dhe 2. Në cilin nga qarqet elektrike do të ndizet llamba? Shpjegoni përgjigjen tuaj.

\_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_



1 pikë

42. Figura tregon një njeri i cili po shtyn biçikletën. Ai e merr energjinë që i duhet për të shtyrë biçikletën nga:


- A) toka ku po ecën;
- B) ajri që ka thithur;
- C) ushqimet që ka ngrënë;
- D) ushtrimet që ka bërë në palestër.



1 pikë

43. Çfarë do të ndodhë midis magnetëve 1 dhe 2 në figurën e mëposhtme?

- A) Do të tërhiqen.
- B) Do të shtyhen.
- C) Njëherë tërhiqen dhe njëherë shtyhen.
- D) Asgjë nuk do të ndodhë midis tyre




1 pikë

44. Figura tregon se kur një qiriri i vendosim një vazo përsipër, flaka e tij do të shuhet pas disa minutave. Kjo ndodh sepse:

1 pikë

- A) vazoja është shumë e ftohtë;
- B) krijohet shumë nxehtësi;
- C) mbaron oksigjeni;
- D) fryn erë.




45. Një nxënës ka hedhur në katër enë të ndryshme të njëjtën sasi uji. Shpjegoni në cilën prej enëve uji do të avullojë më shpejt.

1 pikë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_




46. Në figurën më poshtë guri i peshores ka të njëjtën masë (5kg) në të tria peshoret.

Bazuar në figurën e dhënë, cila nga kutitë ka masën më të madhe?

1 pikë

\_\_\_\_\_




47. Në figurë tregohet ndërtimi i një qelize bimore dhe një qelize shtazore. Tregoni të paktën një ndryshim midis tyre.

1 pikë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_




1. Qeliza bimore      2. Qeliza shtazore

48. Figura tregon fazat e rritjes së një bime. Cili është rendi i duhur i rritjes së bimës, duke filluar nga faza më e hershme?

1 pikë

- A) 5,3,2,4,1
- B) 3,5,2,4,1
- C) 3,2,5,1,4
- D) 1,4,2,5,3



**MODELI III**

**VANAF**

Gjuhë shqipe

*Pse kemi nevojë të flemë?*

Pse është kaq i rëndësishëm gjumi?

Gjatë ditës ju shpenzoni shumë kohë duke vrapuar, duke u hedhur, duke qeshur, ngrënë dhe folur. Ju përdorni shumë energji, dhe në fund të ditës ndiheni të lodhur. Gjumi i jep mundësi trupit tuaj që të pushojë. Por, edhe kur flini, trupi dhe mendja juaj nuk pushojnë plotësisht. Në të vërtetë, ato punojnë shumë për të “karikuar bateritë tuaja”, që, kur të ngriheni, të ndiheni mirë dhe të jeni gati për të filluar ditën e re.

Ndërsa flini, truri juaj grumbullon gjithçka që ju ka ndodhur gjatë ditës. Ai ruan ngjarjet dhe kujtimet më të rëndësishme; rishikon gjëra për të cilat keni pyetur apo jeni shqetësuar dhe ndoshta ju mund të zgjoheni edhe me përgjigje për problemet tuaja.

Gjithashtu, ndërsa flini, ju rriteni. Një element kimik, i quajtur “*hormoni i rritjes*” çlirohet në trupin e njeriut gjatë gjumit dhe ndihmon në rritjen e qelizave dhe të indeve. Hormoni i rritjes e ndihmon trupin të *rigjenerohet*: të shërojë vendet ku mund të jeni çarë a mavijosur apo të qetësojë dhimbjen e muskujve.

Gjumi e ndihmon trupin tuaj, që ta ruajë energjinë. Ju përdorni shumë energji gjatë veprimtarisë së përditshme, por, kur flini, temperatura e trupit bie dhe *metabolizmi* juaj ngadalësohet. Megjithatë, ju ende jeni duke përdorur energji, por shumë më pak se sa përdorni kur jeni zgjuar dhe në aktivitet të plotë.

A keni qëndruar ndonjëherë zgjuar deri natën vonë? Jeni ndier paksa nervozë? E keni pasur të vështirë të ngriheni mëngjesin tjetër? Ndoshta keni pasur probleme me përqendrimin; keni qenë të turbulluar apo *konfuzë* për atë ditë. Në fakt, kjo është mënyra se si trupi juaj po ju thotë: “Kam nevojë për gjumë!” Është shumë e rëndësishme të flesh aq sa duhet. Mungesa e gjumit bën që trupi dhe mendja juaj të mos funksionojë si duhet.

**Fjalori**

*Hormoni* - lëndë që prodhohet nga gjëndrat me rrjedhje të brendshme.

*Metabolizmi* – tërësia e proceseve (reaksioneve kimike) që shndërrojnë ushqimin që hamë në energji për të kryer funksionet bazë të jetës.

*Konfuzë* – i shpërqendruar, i hutuar.

*Rigjeneroj* – riprodhoj, rilind.

1. Për çfarë bën fjalë kjo pjesë?

**1 pikë**

- A) Mënyrën se si fle truri i njeriut.
- B) Mënyrat e ndryshme për të fjetur.
- C) Për sa gjumë keni nevojë.
- D) Si ndikon gjumi në jetën tuaj.

2. Çfarë bën “*hormoni i rritjes*”, ndërsa njerëzit flemë?

**1 pikë**

- A) Ai ndihmon që trupi të rigjenerohet.
- B) Ai ndihmon në ruajtjen e kujtimeve.
- C) Ai ndihmon në zgjidhjen e problemeve.

D) Ai ndihmon që trupi të ngadalësojë funksionet.

3. Duke u mbështetur te kjo pjesë, cila është një nga mënyrat që trupi juaj përdor për t'ju thënë se *ka nevojë për gjumë*. **1 pikë**

- A) Muskujt ju dhembin.
- B) Temperatura e trupit tuaj bie.
- C) Ju pëlqen veprimtaria e përgjithshme.
- D) Ju e keni të vështirë të zgjoheni në mëngjes.

4. Pse autori e ka shkruar këtë pjesë? **1 pikë**

- A) Të shpjegojë rëndësinë e gjumit.
- B) Të na tregojë se kur duhet të flemë.
- C) T'i bindë lexuesit që ta shijojnë gjumin.
- D) T'i argëtojë lexuesit me një histori që lidhet me gjumin.

5. Duke u mbështetur te kjo pjesë, çfarë ndodh nëse njerëzit shkojnë vonë në shtrat? **1 pikë**

- A) Ata rriten shumë shpejt.
- B) Ata ndihen nervozë.
- C) Ata kursejnë energji.
- D) Ata shqetësohen shumë.

6. Gjeni në këtë pjesë **dy arsye** që i përgjigjen pyetjes “*Pse kemi nevojë të flemë?*” **2 pikë**

---

---

7. Në paragrafin e fundit autori bën shumë pyetje. Kujt mendoni se ia drejton ato?

Në cilën vetë janë këto fjali?

**2 pikë**

---

---



### Dëshira e Andit

Andi e pëlqen shumë sportin. Ai i shikon ndeshjet në televizor, i dëgjon në radio, lexon për to në gazetatat sportive. Një ditë vendosi të bëhej atlet.

- Dua të merrem me ndonjë sport, – tha ai.
- Do të të ndihmoj edhe unë, – ia ktheu shoku i tij, Luisi.

Dhe të dy bashkë shkuan te klubi i atletikës. Andi u fut në një grup dhe, kur ata nisën garën e vrapimit, u nis edhe ai. Djali u lodh shumë shpejt dhe nuk arriti që ta përfundonte garën. “Vrapi nuk është për mua”, – i tha ai Luisit.

Ditën tjetër të dy djemtë shkuan në pishina. Andi hipi te shkalla dhe qëndroi mbi platformën e hedhjes. Mori vrull dhe u lëshua poshtë. E goditi ujin me aq forcë, sa ndjeu një dhembje të padurueshme në bark. Aq shumë u shpërnda uji, saqë edhe Luisi që ndodhej aty pranë, u bë qull. “Ëhë, edhe zhytja nuk bëka për mua”, – mendoi.

Djemtë nuk u tërhoqën, por shkuan te fusha e tenisit. Andi e hodhi topin në ajër dhe e goditi me raketë. Topi i tenisit goditi rrjetën. “Edhe tenisi nuk qenka për mua”, – tha djali si nëpër dhëmbë.

Por, Andit i pëlqente të merrej me sport dhe donte të mësonte gjërat më kryesore për të. Ai dëshironte të ndihej i lumtur dhe të provonte gëzimin e fitores, ndaj nuk donte të hiqte dorë...

Të dy shokët shkuan në plazh. Andi hipi mbi një varkë garash dhe u dha fort krahëve. Varka filloi të rrotullohej në vend. “As ky sport nuk bën për mua”, – tha me vete.

Andi provoi volejbollin, basketbollin dhe futbollin. Më pas provoi peshkimin, boksën dhe mundjen. Shkoi të luante edhe shah e pingpong. Kush mund ta mendonte se zgjedhja e një sporti do të ishte kaq e vështirë?!

Andi psherëtiu dhe tha: “Kam provuar pothuajse gjithçka dhe nuk jam i zoti për asgjë.”

Luisi tundi kokën si për t’ia mbështetur mendimin. Dhe vërtetë, Andi bëri gabime në çdo sport që provoi.

- Ti u përpoqe vetëm një herë, – i tha Luisi. – Që të bëhesh atlet i mirë, duhet të ushtrohesh.
- Të ushtrohem? – pyeti Andi. – Pra, ti mendon se nuk mund të jem menjëherë shumë i mirë.
- Po, nuk mundesh menjëherë, – iu përgjigj Luisi.

Duke buzëqeshur, Andi tha: “Epo mirë, do të filloj të praktikohem!”

8. Kjo histori na tregon, kryesisht, se:

1 pikë

- A) është argëtuese të luash me një mik.
- B) të jesh një sportist i mirë, duhet të ushtrohesh.
- C) të jesh atlet, do të thotë që të provosh shumë sporte.
- D) të merresh me sport, është shumë më mirë se sa ta shikosh atë.

9. Shikoni me kujdes tabelën e mëposhtme. Çfarë ndodhi kur Andi provoi zhytjen? Plotësoni vendin bosh në tabelë.

1 pikë

Sportet që provoi Andi.	Çfarë ndodhi?
Atletika	Nuk e përfundoi dot garën.
Zhytja	?
Tenisi	E hodhi topin gabim.

- 10.** Pse autori e përfshin Luisin në këtë histori? **1 pikë**
- A) Ta ndihmojë Andin që të bëhet një atlet.  
 B) T'i tregojë Andit se si t'i ndjekë rregullat.  
 C) T'i shpjegojë Andit rëndësinë e të ushtruarit.  
 D) T'i tregojë Andit se cilat gabime nuk duhet t'i bëjë një sportist.
- 11.** Cili ishte gabimi që bënte Andi? **1 pikë**
- \_\_\_\_\_
- 12.** Mendoni se Andi do ta realizojë qëllimin e tij? Pse mendoni kështu? Gjeni një shembull në pjesën e dhënë që mbështet mendimin tuaj. **2 pikë**
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- 13.** Gjeni në paragrafin e fundit të pjesës më sipër sinonimin e fjalës *ushtrohem*. **1 pikë**
- (të) ushtrohem \_\_\_\_\_
- 14.** Gjeni prapashtesën dhe mbaresën e fjalës *mendonte*. **2 pikë**
- Prapashtesa: \_\_\_\_\_ Mbaresa: \_\_\_\_\_
- 15.** Tregoni kohën e foljes në fjalinë e mëposhtme. **1 pikë**
- Të dy shokët shkuan në plazh.* Koha: \_\_\_\_\_
- 16.** Përcaktoni gjininë dhe rasën e mbiemrit në fjalinë e mëposhtme. **2 pikë**
- Ai e goditi ujin me aq forcë, sa ndjeu një dhembje të padurueshme në bark.*
- Gjinia: \_\_\_\_\_ Rasa: \_\_\_\_\_
- 17.** Gjeni rasën e përemrit vector në fjalinë e mëposhtme. **1 pikë**
- Vrapi nuk është për mua.* Rasa: \_\_\_\_\_
- 18.** Në cilën fjali është përdorur trajta e shkurtër? **1 pikë**
- A) Andi hipi mbi një varkë dhe u dha fort krahëve.  
 B) Djali u lodh shumë shpejt.  
 C) Kur ata nisën garën e vrapimit, u nis edhe ai.  
 D) Mori vrull dhe u lëshua poshtë.

19. Qarkoni fjalinë në të cilën është përdorur *ndajfolja*.

1 pikë

- A) Ai dëshironte të ndiente gëzimin e fitores.
- B) Djali u lodh shpejt dhe nuk arriti ta përfundonte garën.
- C) Zgjedhja e sportit ishte diçka e vështirë.
- D) Djali donte të mësonte gjërat kryesore për sportin.

20. Fjalisë së mëposhtme shtojini një kryefjalë të shprehur me *emër+mbiemër të nyjshëm*.

1 pikë

*Mori vrull dhe u lëshua poshtë.* \_\_\_\_\_

21. Qarkoni fjalinë nxitëse.

1 pikë

- A) Të dy shokët shkuan në plazh.
- B) Djemtë shkuan te fusha e tenisit.
- C) Shkoi të luante edhe shah e pingpong.
- D) Që të bëhesh atlet i mirë, duhet të ushtrohesh.

22. Imagjinoni sikur keni takuar njeriun që keni ëndërruar (një sportist, këngëtar, aktor, shkrimtar për fëmijë etj.).

4 pikë

Ku ishit kur e takuat? Ishit vetëm apo me dikë tjetër? Ku e takuat atë? Çfarë ndjetë? Ishte siç e kishit imagjinuar? Çfarë ndodhi më pas? Si përfundon historia juaj?

Duke u mbështetur në sugjerimet e dhëna më sipër, shkruani një histori të shkurtër.

**Shiko kë takova!**

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

**Matematikë**

23. Arbi punoi 58 orë në muajin mars, 62 orë në muajin prill dhe 60 orë në muajin maj. Cila nga alternativat e mëposhtme tregon llogaritjen e saktë të numrit të përgjithshëm të orëve që ai ka punuar për të tre muajt?

1 pikë

- A)  $50 + 50 + 50$
- B)  $55 + 55 + 55$
- C)  $60 + 60 + 60$
- D)  $65 + 65 + 65$

24. Moris shkon për një shëtitje dhe kthehet në pikën e nisjes në orën 09:00. Nëse shëtitja e tij zgjati 1 orë e 30 minuta, në çfarë ore e filloi ai shëtitjen?


1 pikë

\_\_\_\_\_

25. Grafiku i mëposhtëm tregon numrin e fletoreve të shitura në disa muaj të vitit në një kancelari. Sa fletore u shitën për tre muajt e parë të vitit?

1 pikë

\_\_\_\_\_



26. Sandra përdori një rregull dhe listoi këto numra. Plotësoni vendet bosh sipas këtij rregulli.

1 pikë

1, 3, 5, 7, 9, \_\_\_\_, \_\_\_\_.

27. Rrumbullakosni në dhjetëshen më të afërt numrin:

1 pikë

$1057 \approx$  \_\_\_\_

28. Ergi do të shkojë në një festë dhe do të veshë një këmishë dhe një kollare. Sa kombinime të ndryshme mund të veshë ai?

1 pikë



- A) 2
- B) 4
- C) 6
- D) 8

29. Një sallë provimesh ka 5 rreshta me karrige.  
Çdo rresht ka 35 karrige. Sa karrige ka në sallën e provimeve?

1 pikë

Kryeni veprimin. \_\_\_\_\_

30. Tregoni nëse numri i mëposhtëm është tek apo çift.


1 pikë

34 \_\_\_\_\_

31. Syprina e drejtkëndëshit të ngjyrosur në figurë është 6 njësi katrore.  
Sa do të jetë syprina e drejtkëndëshit që është dy njësi më i gjatë  
dhe dy njësi më i gjerë se drejtkëndëshi i ngjyrosur?

1 pikë

Kryeni veprimin. \_\_\_\_\_



32. Vendos shenjën > ; < ; =


1 pikë

$$-3 \bigcirc 3$$

33. Cili do jetë vazhdimi i figurës?

1 pikë

- A) (1)
- B) (2)
- C) (3)
- D) (4)



34. Cila njësi matëse është më e vogël?

1 pikë

- A) kilometri
- B) milimetri
- C) metri
- D) centimetri

35. Shkruani me fjalë numërorin:

1 pikë

5 370 505 = \_\_\_\_\_

36. Qarkoni thyesën më të madhe se 1:

1 pikë

$$\frac{3}{4}, \frac{5}{2}, \frac{3}{3}, \frac{9}{10}$$

**VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR**

37. Gjeni vlerat e ndryshores  $x$  nga bashkësia  $\{41, 51, 85, 93\}$  të tilla që:

**2 pikë**

$$x - 10 < 51$$

38. Plotësoni pohimin:

**1 pikë**

Pesëkëndëshi i rregullt ka \_\_\_\_\_ brinjë.

39. Në një magazinë janë 585 kg miell që do të shpërndahen në mënyrë të barabartë në 13 furra buke.

**2 pikë**

Sa kg miell do të marrë një furrë buke?

40. Shuma e këndeve të një trekëndëshi është: \_\_\_\_\_

**1 pikë**

Dituri Natyre

41. Cili është prodhuesi në zinxhirin ushqimor që tregohet në figurë?

- A) Kërpudha
- B) Karkaleci
- C) Bari
- D) Bufi



1 pikë

42. Çfarë përmban fara e bimës, që bën të mundur rritjen e bimës së vogël?

- A) Rezerva ushqimore
- B) Minerale
- C) Dhera
- D) Ujë


1 pikë

43. Funkzioni kryesor i lules tek bimët është:

- A) të prodhojë ushqim nga drita e Diellit;
- B) të sigurojë rezervat ushqimore;
- C) të depozitojë ujin për bimën;
- D) të prodhojë fara.

1 pikë

44. Figura tregon dy bimë të cilat ujiten vazhdimisht në mënyrë të rregullt. Shpjegoni pse bima A është e zhvilluar, ndërsa bima B e pazhvilluar.



1 pikë

---



---



---

45. Cila formë e energjisë prodhohet nga djegia e një qiriri?

- A) Energjia mekanike dhe e nxehtësisë.
- B) Energjia elektrike dhe e nxehtësisë.
- C) Energjia e dritës dhe e nxehtësisë.
- D) Energjia e dritës dhe elektrike.

1 pikë

46. Nxënësit e klasës së pestë do të bëjnë një eksperiment në orën e diturisë së natyrës. Informacioni që do të marrin ata, nëse përdorin enën e dhënë në figurë, do të jetë mbi:

- A) lartësinë e trupave të ngurtë;
- B) masën e trupave të ngurtë;
- C) temperaturën e lëngjeve;
- D) vëllimin e lëngjeve.




1 pikë

47. Dridhjet midis tingullit dhe zhurmës janë të ndryshme. Shpjegoni cila nga figurat (1, 2, 3 apo 4) tregon prodhimin e zhurmës.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



1 pikë

48. Në figurë jepen dy magnetë që tërheqin njëri –tjetrin. Vendosni në figurë polet e të dy magnetëve.

1 pikë



49. Tabela tregon temperaturat dhe reshjet (shi ose borë) në katër qytete të ndryshme, në të njëjtën ditë. Në cilin qytet ka rënë borë?

1 pikë

- A) Qytetin A
- B) Qytetin B
- C) Qytetin C
- D) Qytetin D

	Qyteti A	Qyteti B	Qyteti C	Qyteti D
Temperatura më e ulët	12°C	-9°C	15°C	-10
Temperatura më e lartë	20°C	-2 °C	20°C	-7
Reshjet (shi ose borë)	0 cm	6 cm	2.5 cm	0 cm

50. Dielli është në qendër të Sistemit Diellor dhe të gjithë planetët rrotullohen rreth tij. Megjithatë, duket sikur Dielli lind në mëngjes dhe perëndon në mbrëmje. Cila nga arsyet e mëposhtme shpjegon më mirë pse Dielli duket sikur lind në mëngjes dhe perëndon në mbrëmje?

1 pikë

- A) Rrotullimi i Hënës rreth Tokës dhe rreth Diellit.
- B) Rrotullimi i Tokës rreth Diellit.
- C) Rrotullimi i Tokës rreth vetes.
- D) Rrotullimi i Hënës rreth vetes.



**MODELI IV**

**VANAF**

Gjuhë shqipe

*Nusepashket*



Çfarë bëni zakonisht kur një insekt fluturues ulet në krahun tuaj? Shumica prej jush e largojnë me vrap duke e trembur. Çfarë ndodh nëse ky insekt është një nusepashke? Atëherë ju e lini atë të qëndrojë. Çfarë na pëlqen te një nusepashke?

Dikur fermerët mendonin se nusepashket ishin shenjë e fatit të mirë. Nëse gjenin një të tillë në fushë, atëherë të korrat do të ishin të mbara dhe moti do të ishte i mirë. Mbase fermerët e kanë tepruar pak me atë se çfarë mund të bëjë një insekt kaq i vogël. E vërteta është se nusepashket ndihmojnë; ato hanë insektet e dëmshme.

Këto insekte nuk i ha një nusepashke e rritur, por kur ajo është ende një larvë. Nusepashket i vendosin vezët e tyre te gjethet e infektuara nga insekte të tjera. Kur larvat lindin, ato janë shumë të uritura dhe hanë insekte që shkatërrojnë bimët. Një nusepashke larvë mund të hajë mbi 1000 insekte në ditë.

Në vitin 1800 nusepashket u sollën nga Australia në Kaliforni dhe u shpërndanë midis pemëve të portokalleve, të cilat po shkatërroheshin nga insektet. Këto “makina ngrënëse” të vogla, me ngjyrë të kuqe dhe pika të zeza të vogla, i shpëtuan të gjitha pemët.

Nusepashket i bëjnë punët e përditshme pa u shqetësuar për ndonjë gjë. Shumë pak zogj apo insekte i rrezikojnë ato duke i ngrënë, pasi nusepashket lëshojnë një lëng të rrezikshëm nëse hahen.

Gjithashtu, nusepashket e mbrojnë veten duke luajtur sikur kanë vdekur. Ato shtrihen mbi gjethet e bimës dhe qëndrojnë të qeta derisa insekti apo zogu që mund t'i sulmojë, largohet.

Kështu që herën tjetër, kur të shikoni një nusepashke, mendoni se për çfarë shërben ajo. Ndoshta ajo mund të shpëtojë një pemë portokalleje. Ndoshta lëvizja e saj e radhës do të jetë të qëndrojë e shtrirë mbi një gjethë apo t'i kundërvihet një zog u, i cili është 100 herë më i madh se përmasat e saj. Ndoshta mund t'ju tregojë se si do të jetë koha nesër. Kush e di? Në këtë drejtim, nusepashket janë shumë të veçanta.

1. Bazuar në këtë pjesë, pse u sollën nusepashket nga Australia në Kaliforni në vitin 1800? 1 pikë

- A) Për të shtuar më shumë nusepashke në atë zonë.
- B) Për të parashikuar kohën për fermerët.
- C) Për të shpëtuar pemët e portokalleve nga insektet.
- D) Për të lëshuar një lëng të veçantë tek pemët.

2. Sipas këtij artikulli, si e mbrojnë veten nusepashket? 1 pikë

- A) Ato shtrihen mbi gjethet dhe fshihen.
- B) Ato qëndrojnë shumë të qeta.
- C) Ato i thumbojnë armiqtë e tyre.
- D) Ato fluturojnë më shpejt se armiqtë e tyre.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR

3. Në artikull thuhet: “*Ndoshta lëvizja e saj e radhës do të jetë të qëndrojnë e shtrirë mbi një gjethe apo t’i kundërvihet një zog, i cili është 100 herë më i madh se përmasat e saj*”.

Fjala **t’i kundërvihet** ka kuptim të përafërt me:

**1 pikë**

- A) të admirojë,
- B) të mbështetë,
- C) të sfidojë,
- D) të vëzhgojë.

4. Me çfarë ushqehen nusepashket?

**1 pikë**

- A) Insekte,
- B) Zogj,
- C) Gjethe,
- D) Portokalle.

5. Cila nga fjalitë e mëposhtme tregon se çfarë mendon autori për nusepashket?

**1 pikë**

- A) Nusepashket janë insekte interesante.
- B) Nusepashket janë insekte të mërzitshme.
- C) Nusepashket e dëmtojnë natyrën.
- D) Nusepashket hanë më shumë se sa duhet.

6. Një person, që e lexoi këtë artikull, tha: “Nusepashket janë shumë të rëndësishme”. Po ju si mendoni? Pse? **1 pikë**

---

---

7. Disa pjesë të këtij teksti janë shkruar me një gjuhë formale dhe serioze. Pjesë të tjera janë shkruar në një gjuhë joformale dhe bisedore.

**1 pikë**

Për secilën pjesë të tekstit në tabelën poshtë, përcaktoni nëse gjuha është formale ose joformale. Qarkoni “Formale” ose “Joformale” në secilin rresht.

Pjesë nga teksti	A është gjuha formale ose joformale?
Kush e di?	Formale / Joformale
Çfarë na pëlqen te një nusepashke?	Formale / Joformale
Një nusepashke larvë mund të hajë mbi 1000 insekte në ditë.	Formale / Joformale

## *Biblioteka*

Librat në çantë i rëndonin aq shumë sa Davidit i dukej sikur, në vend të tyre, kishte disa tulla. Ato i përplaseshin në shpinë, ndërsa vraponte në trotuar duke goditur me dorë topin e basketbollit. Gjithçka që donte të bënte në atë moment, ishte vetëm të luante me shokun e tij, Endin. Por mamaja e tij kishte pasur tjetër mendim. Ajo i tha se, nëse donte të luante basketboll, duhej të kthente në bibliotekën e qytetit librat që kishte marrë motra e tij.

Sipas mendimit të tij, librat dhe pushimet verore nuk rrinin dot bashkë. Nuk mund të lexonte ndërkohë që luante.

Davidi e kishte mbyllur detyrimin e tij me librat gjatë shkollës.

Të themi të vërtetën, ai kurrë nuk kishte shkelur në bibliotekën e qytetit. As sot nuk është se po e bënte. Ai vetëm se do të linte disa libra jashtë bibliotekës, në një kuti të posaçme ku ato vendoseshin. Por kishte një problem: kutia ishte e mbyllur. Një shënim i vendosur mbi të u tregonte njerëzve se duhej t'i sillnin librat brenda bibliotekës.

Davidi hyri brenda ndërtesës disa minuta para se ajo të mbyllej. Ai i vendosi librat në vendin ku i thanë. Qëndroi të pinte pak ujë dhe më pas shkoi në banjë të freskohej. Kur doli, pa me çudi se dritat e bibliotekës ishin mbyllur. Vendi dukej shkretë. Dera e jashtme ishte mbyllur me çelës dhe nuk mund të hapej nga brenda. Ai ishte zënë në kurth.

Davidi u mundua të përdorte telefonin që ndodhej atje. Por, që të merrte numra jashtë godinës, duhej t'i binte një kodi të cilin ai nuk e kishte. Kur dielli po perëndonte, djali kërkoi çelësin e dritës. Në një nga tavolinat gjeti një abazhur me llambë të vogël që, kur e ndezi, ndriçoi kapakun e një libri. Më në fund mund të shikonte.

Davidi mori një laps me ngjyra dhe shkroi një shënim mbi një copë letër: Kam mbetur i mbyllur brenda. Më ndihmoni! Ai e ngjiti letrën në xhamin e derës kryesore. Sigurisht, dikush që do të kalonte aty pranë, do ta shikonte. Pastaj Davidi e ktheu të gjithë vëmendjen te biblioteka.

Djali u çudit kur zbuloi se ky vend nuk ishte dhe aq i keq. Rreth e qark pa skulptura dhe nëpër mure kishte shumë piktura. Rreshta të tërë ishin me libra pa fund. Mbi një nga tavolinat pa biografinë e një lojtari të famshëm basketbolli, të cilën e mori menjëherë në dorë. Më pas u ul në një karrige të rehatshme dhe e ktheu ndriçimin e llambës në faqet e librit. Vendosi këmbët mbi topin e basketbollit dhe filloi të lexonte. Ai e dinte se do të priste derisa ta nxirrnin, por, për momentin, kjo nuk i dukej një gjë aq e tmerrshme sa e kishte menduar.

### **Fjalor**

\*Kurth- vend nga i cili nuk mund të shpëtojë askush që futet aty.

8. Davidi nuk dëshiron të bllokohet në bibliotekë, sepse:

**1 pikë**

- A) ai ka frikë nga errësira.
- B) atij i pëlqen më mirë të luajë basketboll sesa të lexojë.
- C) ai mendon se mamaja e tij do të shqetësohet shumë.
- D) ai mendon se shoku i tij do të zemërohet.

9. Lexoni fjalinë: *Librat në çantë i rëndonin aq shumë sa Davidit i dukej sikur, në vend të tyre, kishte disa tulla.* Kjo do të thotë se librat janë:

**1 pikë**

- A) të rëndë,
  - B) të mëdhenj,
  - C) të ashpër,
  - D) të fortë.
-

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR

10. Lexoni këtë fjali nga historia: *Djali u çudit kur zbuloi se ky vend nuk ishte dhe aq i keq.* **1 pikë**

Fjala *u çudit* do të thotë:

- A) u zbavit,
- B) u mërzit,
- C) u habit,
- D) u shqetësua.

11. Cila është tema e kësaj pjese? **1 pikë**

- A) Leximi është një aftësi e rëndësishme.
- B) Biblioteka mund të jetë një vend i këndshëm.
- C) Sporti mund të jetë po aq argëtues sa leximi.
- D) Është e rëndësishme që librat të kthehen në bibliotekë në kohë.

12. Kjo histori është më shumë një: **1 pikë**

- A) legjendë,
- B) histori me mistere,
- C) histori e jetës së përditshme,
- D) histori fantastiko-shkencore.

13. Gjeni dy momente në këtë pjesë që tregojnë marrëdhënien e Davidit me librat. **2 pikë**

---

---

14. Pse, në fund të pjesës, Davidit nuk i duket diçka e tmerrshme që është mbyllur brenda bibliotekës? **1 pikë**

---

---

15. Gjeni rrënjën dhe mbaresën e fjalës *vendosi*. 2 pikë
- Rrënja: \_\_\_\_\_ Mbaresa: \_\_\_\_\_
16. Shkruani numrin shumës të grupit emëror *mendim i bukur*. 1 pikë
- Numri shumës: \_\_\_\_\_
17. Gjeni mbiemrin në fjalinë e mëposhtme: 1 pikë
- Ai kishte një llambë të vogël që, kur e ndezi, ndriçoi kapakun e një libri.*
- Mbiemri: \_\_\_\_\_
18. Tregoni kohën dhe vetën e foljes në fjalinë e mëposhtme: 2 pikë
- Në një nga tavolinat gjeti një abazhur.*
- Koha: \_\_\_\_\_ Veta: \_\_\_\_\_
19. Formoni një fjali me përemrin e pacaktuar *dikush* në rasën dhanore. 1 pikë
- \_\_\_\_\_
20. Rishkruani fjalinë e mëposhtme duke zëvendësuar kryefjalën me një emër në numrin shumës. 1 pikë
- Përshtatni foljen me kryefjalën.
- Ai e ngjiti letrën në xhamin e derës kryesore.* \_\_\_\_\_
21. Zgjeroni fjalinë e mëposhtme me një rrethanor vendi, të shprehur me emër me parafjalë. 1 pikë
- Kur dielli po perëndonte, djali kërkoi çelësin e dritës.*
- \_\_\_\_\_
22. Shkruani fjalinë nxitëse që ndodhet në paragrafin e parafundit të historisë. 1 pikë
- \_\_\_\_\_
23. Rilexoni paragrafin e mëposhtëm. Vendosni thonjëzat aty ku mungojnë. 1 pikë
- Davidi mori një laps me ngjyra dhe shkroi një shënim mbi një copë letër: Kam mbetur i mbyllur brenda. Më ndihmoni! Ai e ngjiti letrën në xhamin e derës kryesore...
-

## VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR

24. Lexoni edhe një herë me kujdes pjesën “Biblioteka”. Imagjinoni se si mund të ketë vazhduar dhe të jetë mbyllur kjo histori. **4 pikë**

Sigurohuni që në vazhdimin dhe mbylljen e historisë të përfshini:

- Çfarë ndodh ndërsa Davidi rri i ulur dhe lexon librin e tij të preferuar?
- Si ndihet tani ai mes librave, krahasuar me ndjenjat që kishte për to dikur?
- Si del në fund nga biblioteka?

### Kujdes!

- Mundohuni të shkruani në një gjuhë interesante dhe pa gabime.


Ideja	Organizimi	Stili	Saktësia gjuhësore	Pikët
1	1	1	1	4

**Matematikë**

25. Si paraqitet me numëror “Pesëmilion e pesëdhjetëmijë e shtatëqind e tetë”. 1 pikë

\_\_\_\_\_

26. Zbërtheni saktë numrin: 1 pikë

$$207\,843 = \text{___} \text{QM} + \text{___} \text{DHM} + \text{___} \text{M} + \text{___} \text{Q} + \text{___} \text{DH} + \text{___} \text{NJ}$$

27. Shkruani të gjithë numrat e plotë që ndodhen midis  $-3$  dhe  $3$ . 1 pikë

\_\_\_\_\_

28. Plotësoni. 1 pikë

$$2,07 \text{ km} = \text{_____} \text{ m}$$

29. Adi donte të përdorte makinën llogaritëse për të mbledhur  $1\,563 + 319$ . Ai shtypi gabimisht  $1\,263 + 319$ .

Çfarë mund të bëjë ai për të korrigjuar gabimin e tij? 1 pikë

- A) Të shtojë 300
- B) Të zbresë 300
- C) Të shtojë 3
- D) Të zbresë 3

30. Cili është numri më i madh që mund të formojmë duke përdorur shifrat 4, 3, 8 dhe 1?

Përdorni çdo shifër vetëm një herë. 1 pikë

Përgjigje: \_\_\_\_\_

31. Juli do të vendosë në një raft që është 99 cm i gjatë, disa kuti me gjatësi 33 cm.

Sa kuti mund të vendosë Juli në raft? 1 pikë

Kryeni veprimin. \_\_\_\_\_

32. Një libër ka 140 faqe gjithsej. Tanja, 2 ditët e para, lexoi nga 30 faqe. Cili nga barazimet përdoret për të gjetur se sa faqe i mbetën pa lexuar? 1 pikë

- A)  $140 + 30$
- B)  $140 - 2 \times 30$
- C)  $140 - 30$
- D)  $2 \times 30 - 140$

33. Gjeni numrin më të madh, që plotëson mosbarazimin: 1 pikë

$$x - 30 < 70$$



VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR

34. Trekëndëshi ABC është kënddrejtë në kulmin  $\hat{B}$ . 1 pikë  
Sa është masa e këndit  $\hat{C}$ , kur masa e këndit  $\hat{A} = 45^\circ$ ?
35. Syprina e një drejtkëndëshi është  $360 \text{ cm}^2$ . Njëra brinjë është  $40 \text{ cm}$ . 1 pikë  
Sa është gjatësia e brinjës tjetër?  
Kryeni veprimin. \_\_\_\_\_
36. Renditni thyesat nga më e vogla tek më e madhja. 1 pikë  
 $\frac{3}{4}, \frac{1}{3}, \frac{4}{6}$  \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_
37. Plotësoni:  $2 \text{ orë e } 20 \text{ minuta} + 50 \text{ minuta} = \text{_____ orë} \text{_____ minuta}$ . 1 pikë
38. Nëna bleu  $3 \text{ kg}$  dardha me  $120 \text{ lekë/kg}$  dhe  $6 \text{ kg}$  rrush me  $136 \text{ lekë/kg}$ . Ajo i dha shitëses  $5\,000 \text{ lekë}$ . 3 pikë  
Sa lekë do t'i kthejë shitësja? Zgjidhni problemin me kërkesa.
-

39. Gjeni vlerën e  $\Delta$ , në mënyrë që barazimi të jetë i vërtetë.

1 pikë

$$(6 + 4) \times 3 = \Delta + 15$$

Kryeni veprimin. \_\_\_\_\_

40. Cili nga veprimet e mëposhtme duhet të kryhet për të gjetur herësin e prodhimit të numrave 35 me 120 me numrin 30?


1 pikë

- A)  $35 \times 120 \times 30$
- B)  $35 \times 120 : 30$
- C)  $35 \times 120 + 30$
- D)  $35 \times 120 - 30$

41. Në një qendër tregtare, katër dyqane për fëmijë kanë vendndodhje të ndryshme. Cili nga dyqanet ka koordinatat  $(-1, -3)$ ?

1 pikë

- A) Miqtë e Librit,
- B) Kësulkuqja,
- C) Shtëpia e Lodrave,
- D) Miqtë e Borëbardhës.





42. Albi gjuajti tri herë në tabelë me tri shigjeta. Herën e parë ai fitoi 6 pikë (si në figurë).

Herën e dytë ai fitoi 8 pikë (si në figurë).

Sa pikë fitoi Albi herën e tretë, kur i ka hedhur shigjetat si në figurë?

1 pikë

- A) 8
- B) 10
- C) 12
- D) 14



**Dituri natyre**

43. Tabela tregon motin për katër ditë të ndryshme.

	Dita 1	Dita 2	Dita 3	Dita 4
Temperatura më e ulët	2°C	-9°C	2°C	-2
Temperatura më e lartë	8°C	-2 °C	5°C	2
Qielli	Me re	I pastër	Pjesërisht me re	Me re
Shpejtësia e erës (km/h)	20	10	15	5

Në cilën nga ditët ka më shumë mundësi të bjerë borë?


**1 pikë**

- A) Në "Dita 1",
- B) Në "Dita 2",
- C) Në "Dita 3",
- D) Në "Dita 4".

44. Figura tregon 4 vende në Tokë. Vendet 1, 2, 3 dhe 4 janë të gjithë në nivel deti. Cili nga vendet ka dimrat më të ftohtë?

**1 pikë**

- A) Vendi 1,
- B) Vendi 2,
- C) Vendi 3,
- D) Vendi 4.



45. Cilat nga substancat e mëposhtme formojnë një tretësirë, kur përzihen së bashku?

**1 pikë**

- A) Uji dhe kripa,
- B) Uji dhe rëra,
- C) Kripa dhe rëra,
- D) Kripa dhe sheqeri.

46. Cili nga materialet e mëposhtëm është përcjellës i mirë i elektricitetit?

**1 pikë**

- A) Guri,
- B) Druri,
- C) Metali,
- D) Plastika.

## VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR

47. Iri e di që Toka rrotullohet rreth boshtit të saj. Cila nga alternativat e mëposhtme tregon që Toka rrotullohet rreth boshtit të saj? 1 pikë


- A) Formimi i ditës dhe i natës.
- B) Formimi i fazave të Hënës
- C) Ndryshimi i klimës gjatë vitit.
- D) Ndryshimi i motit gjatë ditës.

48. Cila pjesë e bimës shndërrohet në frutë? 1 pikë

- A) Lulja.
- B) Kërçelli.
- C) Gjethja.
- D) Rrënja.


49. Një nxënës ka hedhur në katër enë të ndryshme të njëjtën sasi uji. Në cilën prej enëve uji do të avullojë më shpejt? 1 pikë

- A) Në enën A.
- B) Në enën B.
- C) Në enën C.
- D) Në enën D.



50. Katër hinka janë mbushur me të njëjtën sasi me gurë, sheqer, rërë të imët dhe rërë të trashë, siç tregohet në figurë. Brenda çdo hinke hidhet e njëjta sasi uji. Në cilën nga hinkat uji do të kalojë më shpejt? 1 pikë


- A) Në hinkën me gurë.
- B) Në hinkën me sheqer.
- C) Në hinkën me rërë të imët.
- D) Në hinkën me rërë të trashë.



51. Figura tregon katër magnetë. Çfarë do të ndodhë midis magnetëve 3 dhe 4?

1 pikë

- A) Do të tërhiqen.
- B) Do të shtyhen.
- C) Njëherë tërhiqen dhe njëherë shtyhen.
- D) Asgjë nuk do të ndodhë midis tyre.



52. Figura e mëposhtme tregon pozicionin e Tokës dhe Hënës përkundrejt Diellit, në një moment të caktuar.

Kjo figurë paraqet:

1 pikë

- A) formimin e Eklipsit të Hënës,
- B) formimin e Eklipsit të Diellit,
- C) formimin e ditë – natës,
- D) formimin e stinëve.



## SEKSIONI 2

## SKEMA E VLERËSIMIT

### MODELI I

Gjuhë Shqipe

**PJESA I**

<b>Pyetja 1</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 2</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 3</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 4</b>	<b>C</b>	<b>1 pikë</b>
<b>Pyetja 5</b>	<b>A</b>	<b>1 pikë</b>

**Pyetja 6** **1 pikë**

**Model përgjigjeje**

- Më pëlqen mënyra se si veptoi luani, sepse ai zgjodhi një lojë ku të dyja kafshët patën mundësi të tregonin aftësitë e tyre. Luani u tregua i drejtë me kafshët, sepse vlerësoi aftësitë e secilit.

**1 pikë** Nëse shpreh mendimin se ai pëlqeu ose jo mënyra se si veptoi luani.

**0 pikë** Përgjigjja është gabim ose nuk ka përgjigje fare.

**Shënim:**

*Në rast se nxënësi jep një përgjigje që nuk përfaqësohet me modelin e dhënë më sipër, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, atëherë ai do të marrë pikët e plota.*

**Pyetja 7** **1 pikë**

**Model përgjigjeje**

**1 pikë** Krokodili dhe elefanti arrijnë pranë murit.

**Pyetja 8** **B** **1 pikë**

**Pyetja 9**

**1 pikë** **të madhe**



**Pyetja 10**

**1 pikë** Nëse ndërton një fjali ku kundrinori i përdorur të jetë shprehur me emër.

---

**Pyetja 11**                    **A**        **1 pikë**

**Pyetja 12**

**1 pikë**                    kaloi - koha e shkuar (ose e kryer e thjeshtë)

**Pyetja 13**

**1 pikë**                    **rasa dhanore**

**Pyetja 14**                    **B**        **1 pikë**

**Pyetja 15**                    **C**        **1 pikë**

**Pyetja 16**                    **D**        **1 pikë**

**Pyetja 17**                    **1 pikë**

G. Shishja e qumështit ishte bosh.	1
H. Kamioni erdhi të boshatisë depozitën e shisheve.	3
I. Shishja u copëtua në pjesë të vogla.	5
J. E çova shishen te depozita e shisheve.	2
K. Xhami i ri u krijua nga shishet e thyera.	6
L. Ata i çuan shishet në fabrikën e qelqit.	4

**Nëse në përgjigjen e dhënë nxënësi gabon në renditje (qoftë edhe një) ai do të vlerësohet me 0 pikë**

**Pyetja 18**      **3 pikë**

Për pjesën *të shkruajmë* do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme

**Ideja**

**1 pikë**

- Shkruan një ngjarje reale apo të trilluar;
- Përfshin personazhe (realë apo të trilluar);
- Tregon vendin ku ndodh ngjarja.

**Organizimi**

**1 pikë**

- Ngjarja ka një fillim të qartë, vazhdim dhe mbyllje

**Stili dhe saktësia gramatikore**

**1 pikë**

- Përdor si duhet strukturat gramatikore;
- Përdor gjuhën në mënyrë efektive, me fjalor dhe fjali të pasura;
- Respekton rregullat e drejtshkrimit.

Matematikë

**Pyetja 19**

**Përgjigje:** 1.1 , 1.01, 1, 0.1

**Nxënësi fiton:**

**2 pikë** nëse rendit saktë të gjitha vlerat.

**1 pikë** nëse rendit saktë dy vlerat e para.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 20**

**Përgjigje:** Alternativa C

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë** nëse qarkon alternativën C.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 21**

**Përgjigje:** A) G B) V

**Nxënësi fiton:**

**2 pikë** nëse qarkon për pohimin e parë “G” dhe për pohimin e dytë “V”.

**1 pikë** nëse qarkon saktë vetëm njërin nga pohimet.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 22**

**Përgjigje:** Vlera e këndit që mungon është  $55^0$ . Trekëndëshi është dybrinjënjëshëm.

**Nxënësi fiton:**

**2 pikë** nëse përcakton saktë masën e këndit dhe llojin e trekëndëshit.

**1 pikë** nëse përcakton saktë masën e këndit.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 23**

**Përgjigje:**  $\frac{2}{3} \text{ e } 6 = 4$  Racione me fruta.

**Nxënësi fiton:**

**2 pikë** nëse shpreh saktë në thyesë të dhënë e problemës dhe kryen saktë veprimet.

**1 pikë** nëse shpreh saktë në thyesë të dhënë e problemës.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 24**

**Përgjigje:** Vlera e fytyrës së mërzitur është 7.

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë** nëse përcakton saktë vlerën e fytyrës së mërzitur.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 25**

**Përgjigje:**

$$\frac{1}{6} + \frac{4}{6} = \frac{5}{6}$$

**Nxënësi fiton:**

**3 pikë** nëse shpreh saktë në thyesë pjesën e parë dhe të dytë të ngjyrosur dhe kryen saktë veprimet;

**2 pikë** nëse shpreh saktë në thyesë pjesën e parë dhe të dytë të ngjyrosur.

**1 pikë** nëse shpreh saktë në thyesë pjesën e parë **OSE** të dytë të ngjyrosur.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

---

**Pyetja 26 – a**

**Nxënësi fiton:**

**2 pikë** nëse përcakton saktë në rrjetin koordinativ pikat.

**1 pikë** nëse përcakton saktë vetëm dy nga pikat.

**0 pikë** nëse përcakton gabim **OSE** nuk përcakton asnjë nga pikat.

---

**Pyetja 26 – b**

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë** nëse bashkon saktë pikat e gjetura në rrjetin koordinativ.

**0 pikë** nëse bashkon gabim **OSE** nuk bashkon pikat.

---

**Pyetja 26 – c**

**Përgjigje:** Figura që formohet është drejtkëndësh.

**Nxënësi fiton:**

